

**Konferenca e 35-të ndërkombëtare e komisionerëve të mbrojtjes së të dhënave dhe të privatësisë**

**Varshavë, Poloni**

**Nga data 23 deri 26 shtator 2013**

**Rezolutë mbi përfshirjen e mbrojtjes së të dhënave dhe mbrojtjes së privatësisë në të drejtën ndërkombëtare**

*Duke rikujtuar se:*

- Konferenca e 27-të në Montrë', iu bashkua Kombeve të Bashkuara, në përgatitjen e një instrumenti ligjor të detyrueshëm, duke i bërë qartësisht dhe saktësisht, të drejtat për mbrojtje të privatësisë dhe të dhënave, të drejta njeriu për t'u zbatuar.
- Konferenca e 28-të e Monrealit, rekomandoi përmirësimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në atë që ka të bëjë me mbrojtjen e privatësisë dhe të së dhënave.
- Konferenca e 30-të e Strasburgut, miratoi një rezolutë mbi nevojën urgjente për mbrojtje të privatësisë, në një botë pa kufi dhe hartimin e propozimit të përbashkët me qëllim përcaktimin e normave ndërkombëtare, në atë që ka të bëjë me mbrojtjen e privatësisë dhe të së dhënave.
- Konferenca e 31-të në Madrid, miratoi normat ndërkombëtare në lidhje me mbrojtjen e privatësisë dhe të së dhënave (Deklarata e Madridit).
- Konferenca e 32-të në Jeruzalem, nxiti Qeveritë në organizimin e një konference ndër-qeveritare, me qëllim hartimin e një marrëveshjeje ligjore të detyrueshme mbi mbrojtjen e privatësisë dhe të së dhënave, për të siguruar zbatimin e Deklaratës së Madridit.

Dhe duke rikujtuar rëndësinë e instrumenteve ekzistuese, të së drejtës ndërkombëtare, që parashikojnë rregulla dhe norma për mbrojtjen e të dhënave me karakter personal, në veçanti Konventën për mbrojtjen e personave nga përpunimi automatik i të dhënave me karakter personal, të Këshillit të Evropës (STE nr. 108).

**Konferenca e 35-të ndërkombëtare vëren:**

Se është urgjent hartimi i një marrëveshjeje ligjore të detyrueshme, mbi mbrojtjen e të dhënave, që do të garantonte respektimin e të drejtave të njeriut, falë mbrojtjes së privatësisë, të informacioneve personale dhe të integritetit të rrjeteve, për më tepër të rritet transparenca e proceseve në lidhje me përpunimin e të dhënave, duke mbajtur parasysh, në mënyrë të ekuilibruar, sigurinë, interesat ekonomike dhe lirinë e shprehjes.

## **Dhe vendos:**

T'u bashkohet qeverive në promovimin e miratimit të një protokollit shtesë të nenit 17 të Marrëveshjes ndërkombëtare në lidhje me të drejtat civile dhe politike (PIDCP). Ky protokoll duhet të bazohet në normat e hartuara dhe të miratuara nga Konferenca ndërkombëtare, ashtu si dhe në saktësimet e saj të shprehura në rishikimin e përgjithshëm nr. 16, në lidhje me Marrëveshjen, me qëllim favorizimin e përcaktimit të normave botërore, për sa i përket mbrojtjes së të dhënave me karakter personal dhe mbrojtjen e privatësisë, konform sundimit të së drejtës.

## **Shënim shpjegues**

Konferenca e 35-të ndërkombëtare vëren se Marrëveshja ndërkombëtare në lidhje me të drejtat civile dhe politike, e cila u miratua nga Asambleja e përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 1996-n dhe e ratifikuar nga 167 Shtete, siguron tashmë një kuadër ligjor për sa i përket mbrojtjes së privatësisë.

Neni 17 i Marrëveshjes Ndërkombëtare lexohet si vijon:

1. Askush s'mund të jetë subjekt ndërhyrjeje arbitrare apo të paligjshme në jetën e tij private, familjare, në banesën e tij apo korrespondencën, as cenimesh të paligjshme ndaj nderit dhe reputacionit të tij.
2. Çdo person ka të drejtë për mbrojtje nga ligji ndaj ndërhyrjeve apo cenimeve të tilla.

Nga ana tjetër, rishikimi i përgjithshëm nr. 16 i Marrëveshjes, përmban më shumë saktësime për sa i përket kërkesave në lidhje me mbrojtjen e të dhënave, të përshkruara në nenin 17. Ai parashikon gjithashtu se:

- Mbledhja dhe ruajtja, nga e autoriteteve publike, nga persona apo organizma privatë, të të dhënave në lidhje me jetën private të individëve, në kompjuterë, në baza të dhënash dhe sipas procedurash të tjera, duhet të rregullohen me ligj.
- Shteti duhet të marrë masa efikase me qëllim që të sigurohet që këto të dhëna nuk do të bien në duart e personave të paautorizuar me ligj, që t'i përftojnë, përpunojnë apo shfrytëzojnë.
- Këto të dhëna nuk do të përdoren kurrë për qëllime të papërputhshme me Marrëveshjen.
- Çdo individ duhet të ketë mundësi të përcaktojë autoritetet publike, personat apo organizmat privatë që kanë apo mund të kenë kontrollin e dosjeve që i përkasin dhe për cilat qëllime. Ai duhet po ashtu, të ketë të drejtën e kërkesës për korrigjim apo fshirje të këtyre dosjeve.
- Cënimi i këtyre të drejtave mund të bazohet vetëm në ligj, i cili duhet të jetë edhe vetë konform Marrëveshjes.

Këtyre kërkesave u shtohet edhe detyrimi për transparencë, në fushën e përpunimit të të dhënave, i cili bën përgjegjës organizatën përkatëse në lidhje me ruajtjen, në veçanti në atë që ka të bëjë me komunikimin, korrigjimin dhe fshirjen e këtyre të dhënave, të cilat janë parime themelore të mbrojtjes së të dhënave personale.

*Komisioni Federal i Tregtisë (Shtetet e Bashkuara) abstenoj votimin e kësaj rezolute.*